

Plotësimi i hendekut ndërmjet nevojave, kapaciteteve dhe mundësive: Kërkime dhe rekomandime të CIVILit të Gjelbër

Agjenda e gjelbër, çështjet mjedisore dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë pjesë thelbësore e programeve politike dhe pjesë e PR të institucioneve në nivel shtetëror dhe vendor. Vitet e fundit fokusi i publikut të gjerë, i medias, i shoqërisë civile, madje edhe i fushës akademike është orientuar drejt ringjalljes së temave që lidhen me çështjet e gjelbra, kuptimi dhe promovimi i tyre.

Projekti "Forumi i Gjelbër" i CIVILit të Gjelbër (njësia organizative e CIVIL– Qendrës për Liri) ofroi një platformë për debat mbi çështjet kryesore të gjelbra. Projekti identifikon një sërë faktorësh pozitivë dhe negativë socio-politikë që lidhen me të ardhmen e gjelbër të vendit.

Projekti përfshiu një numër të madh ekspertësh për çështjet e gjelbra, politikanë, vendimmarrës dhe profesionistë nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Në të njëjtën kohë, ekipi i CIVIL-it punoi në sistemimin e përvojave dhe hulumtimeve të mëparshme, duke marrë parasysh prezantimet e pjesëmarrësve në panelin e diskutimeve të CIVILit të Gjelbër. Analistët me përvojë brenda organizatës formuluan rekomandime të bazuara në monitorimin dhe analizën e vazhdueshme të kushteve aktuale në lidhje me çështjet e gjelbra, duke përfshirë analiza krahasuese me trendet botërore.

I. KAPACITETI I SHTETIT DHE INSTITUCIONEVE PËR KRIJIM DHE ZBATIM NJË AGJENDË TË GJELBËR

Një nga çështjet kyçe për të cilat projekti tentoi të jep përgjigje, është: **A kanë kapacitet shteti dhe institucionet të krijojnë dhe të zbatojnë agjendë të gjelbër?**

Në bazë të hulumtimeve të CIVILit të Gjelbër, mund të tërhiqen disa poenta dhe rekomandime.

1. Rregullorja ligjore në harmoni me BE

Duhet të forcohen orvatjet për sjelljen e rregullores ligjore në harmoni me ligjvënien e BE. Kjo nënkupton bashkëpunim të plotë dhe këmbim me institucionet evropiane të cilat do të jenë të ftuara të ndihmojnë në krijimin e zgjidhjeve ligjore në me kushtet dhe gjendjet përkatëse maqedonase në domenin e agjendave të gjelbra.

Nuk duhet lënë në harresë as pjesëmarrja e shoqërisë qytetare, posaçërisht organizatat që kanë përvojë me monitorim dhe analiza të politikave, si dhe kuptimin e vlerave të gjelbra.

2. Strategji e zhvillimit me synime të qarta dhe të arritshme

Një rekomandim i fortë i CIVILit të Gjelbër dhe pjesëmarrësve në projekt, është të punohet më konsistencë në krijimin dhe zbatimin e një strategjie dhe strategjish zhvillimore që në afat të mesëm dhe afatgjatë do të kenë qëllime plotësisht të qarta dhe të arritshme, nga të cilat do të dalin plane veprimi realiste. .

Në këtë fushë, mund të ndihmojnë ekspertë të pavarur dhe organizata që kanë përvojë në krijimin e strategjive për politika dhe praktika në një kontekst më të gjerë socio-politik, por edhe me fokus në çështjet e gjelbra.

2. Tejkalimi i kulturës së mosndëshkimit dhe antikorrupsioni

Duhet të ndërmerren hapa urgjent për të kapërcyer kulturën e mosndëshkimit. Kjo nënkupton luftën kundër korrupsionit, si dhe forcimin e transparencës dhe përgjegjësisë së institucioneve.

Në këtë kuadër, një pjesë e veprimeve mund të konsistojë në forcimin e institucioneve, por edhe futjen e peshkës për të punësuar, ndër të tjera, gardianët komunalë, të cilët do të bashkëpunojnë ngushtë me policinë. Në të njëjtën kohë, duhet bërë përpjekje për të forcuar gjykatat në drejtim të zgjidhjes më të shpejtë dhe të vazhdueshme të rasteve të krimit mjedisor.

3. Më tepër investime në agjendën e gjelbër

Shteti duhet të ndajë buxhete më të larta për financimin e aktiviteteve dhe projekteve që janë pjesë e agjendës së gjelbër, si dhe fushata për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe ndryshimin e politikave dhe praktikave në nivel lokal dhe qendror.

4. Forcimi i resurseve njerëzore

Sa i përket burimeve njerëzore, është evidentuar një mungesë kronike e inspektorëve mjedisorë dhe ekspertëve në fusha të caktuara të agjendës së gjelbër.

Institucionet duhet të punojnë në forcimin e burimeve njerëzore apo rikualifikimin e kapaciteteve ekzistuese.

5. Edukimi i publikut

Shteti, vetëqeverisja lokale dhe donatorët ndërkombëtarë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje forcimit të vetëdijes publike dhe edukimit të qytetarëve. CIVILI i Gjelbër rekomandon krijimin e një fondi të posaçëm për projektet në këtë fushë, si dhe përpjekje reformuese në procesin arsimor për të krijuar shprehje dhe qëndrime që janë në përputhje me vlerat e gjelbra dhe agjendën e gjelbër të vendit dhe BE-së.

I. SA ËSHTË REALE AGJENDA E GJELBËR?

Kuptimi i agjendës së gjelbër në Maqedoninë e Veriut, perceptimi dhe vënia e saj në kontekstin e jetës së përditshme shoqërore dhe politike ndryshon. Kjo varet edhe nga rregullimi hierarkik i shtetit dhe i institucioneve.

Qeveria ka prirje drejt aspektit ekonomik dhe qëndrueshmërisë, ndërsa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor drejt fushave prioritare.

1. Harmonizimi i Agjendës së Gjelbër me gjendjet dhe mundësitë reale

Në hulumtim, CIVIL i Gjellbër ka ardhur në përfundim se Agjenda e Gjellbër nuk është në përputhje me mundësitë reale të institucioneve, e aq më pak me mundësitë buxhetore. Kjo kontribuon në mospërputhjen midis agjendave dhe ideve të projektit dhe asaj që zbatohet në të vërtetë.

Institucionet përballen me një sfidë të madhe në zbatimin e legjislacionit dhe projekteve të parashikuara nga agjenda e gjellbër. Kjo është për shkak të një sërë arsyesh objektive (kriza ekonomike dhe ushtarake, mungesa e financave etj.), por edhe për arsye subjektive (mungesa e burimeve njerëzore, mospërputhja dhe cilësia e ulët e zbatimit të aktiviteteve, etj.)

Mes tjerash, në këtë sferë është e nevojshme që të angazhohen më shumë ekspertë në krijimin e strategjive dhe politikave, si dhe punë në ndryshime dhe harmonizime të ligjeve. Kjo do të kontribuojë në zgjidhjen e një pjese të çështjeve kyçe të gjelbra që prekin qytetarët në baza ditore. Por prioritet duhet të jetë përafrimi i Agjendës së Gjellbër me mundësitë dhe kapacitetet reale.

2. Pjesëmarrja e shoqërisë qytetare

Pjesëmarrja e shoqërisë civile, si në botë ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut, paraqet një burim kyç për vendin në realizimin e Agjendës së Gjellbër.

Nga ana tjetër, shoqatat civile, përmes edukimit dhe projekteve, të fokusuar në fusha specifike të Agjendës së Gjellbër, përpiqen të kontribuojnë në çështje elementare, si ndotja e ajrit, ndotja e tokës, infrastruktura e gjellbër, mbrojtja e mjedisit etj. Qasja e tyre ndaj agjendës së gjellbër është në drejtim të perceptimit të idesë së gjellbër si një tjetër mjet politik.

3. Përfshirja e mediave në informimin e publikut për çështjet e gjelbra

Rekomandimi i CIVILit të Gjellbër është përfshirja më e madhe e mediave në informimin e publikut për çështjet e gjelbra. Në atë drejtim mediat as nuk shfaqin interes, as nuk kanë njohuri të mjaftueshme se cila është agjenda e gjellbër, cilat janë përfitimet, (mos)varësia nga çështja evropiane. Ata marrin informacion nga vendimmarrësit apo shoqatat civile mjedisore përmes njoftimeve apo konferencave për shtyp që informojnë për suksese dhe dështime të caktuara në segmente të caktuara të temave të gjelbra.

Gazetaria hulumtuese tregon interes, por motivimi ndonjëherë varet nga transparenca e institucioneve dhe aktualiteti i temës. Shumica e tregimeve kanë kontekst politik. Motivi më i zakonshëm për kërkime janë kurset e gazetarisë me çmime me tema specifike, që mbulojnë një segment të çështjeve të gjelbra. I tillë është shembulli me konkursin e Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë, ku fokusi është përballja me ndotjen e ajrit dhe zgjidhjet e mundshme.

Rekomandime

Përjetimi i Agjendës së Gjellbër si një nevojë reale, pjesë e kontekstit të përditshëm social dhe politik në të cilin jetojnë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, është e mundur për CIVIL in e Gjellbër nëse investon në:

1. Edukim për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut

Hulumtimi i CIVILit të Gjelbër në kuadër të përvojës shumëvjeçare në informimin, përfaqësimin dhe promovimin e vlerave të gjelbra tregon se ndërgjegjësimi i publikut krijohet nga trazirat e përditshme politike që tentojnë të promovojnë vlerat evropiane dhe demokracinë nga njëra anë, nacionalizmin, keqinformimin. dhe agjendat anti-perëndimore nga ana tjetër, në një konflikt të vazhdueshëm, i cili nuk i lë hapësirë të mjaftueshme të qytetarët për të krijuar një rishikim kritik të çështjeve prioritare të gjelbra.

CIVILI i Gjelbër rekomandon një angazhim të fuqishëm të shtetit në edukimin dhe promovimin e vlerave të gjelbra, komunikim të vazhdueshëm dhe hapje më të madhe ndaj publikut, informim objektiv si për sukseset ashtu edhe për sfidat me të cilat ballafaqohen në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të mbuluara nga Agjenda e Gjelbër.

Organizatave qytetare kanë një përgjegjësi edhe më të madhe në atë drejtim, veçanërisht ato organizata që kanë si qëllim parësor fushat e Agjendës së Gjelbër. Hapja ndaj publikut duke përdorur të gjitha mjetet që kanë në dispozicion, si dhe bashkëpunimi i ndërsjellë do të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes publike, si dhe edukimin fillor të qytetarëve.

1. Hapësirë më e madhe mediatike për tema të gjelbra

Në këtë kontekst, komunikimi ndërmjet institucioneve kompetente dhe vendimmarrësve dhe mediave luan një rol të rëndësishëm. Hapësira mediatike duhet t'i hapë rrugën një qasjeje edukative ndaj çështjeve të gjelbra, informacioni që publikohet duhet të verifikohet gjithmonë, debatet, raportet dhe kontributet për temat e gjelbra duhet të jenë pjesë integrale e politikës ditore.

1. Transparenca e institucioneve

Rekomandimi i CIVILit të Gjelbër është që institucionet të punojnë në hapjen e tyre ndaj publikut, t'u përgjigjen kërkesave për informacion të natyrës publike, të jenë të disponueshme për mediat dhe publikun e gjerë.

II. KAPACITETET INSTITUCIONALE DHE NJOHURITË SISTEMATIKE BRENDA AGJENDËS SË GJELBËR

1. Kredencialet

Qeveria, ministritë përkatëse, Kuvendi, si dhe institucionet në nivel vendor kanë një gamë të gjerë kompetencash, por edhe një diferencë të madhe në ekspertizë dhe burime njerëzore. Komunikimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave varet nga dallimet politike, burimet financiare dhe mbi të gjitha nga vullneti i vendimmarrësve në nivel qendror dhe lokal.

1. Sfidat

Zbatimi i agjendës së gjelbër në fusha të caktuara dështon për shkak të zgjidhjeve ligjore jofunksionale, si dhe posedimit të autoriteteve më të mëdha në nivel vendor dhe më pak burimeve financiare dhe

njerëzore. Kur bëhet fjalë për investime kapitale, sipas hulumtimit të CIVILit të Gjellbër, para së gjithash përmes fondeve evropiane, shteti apo institucionet kompetente detyrohen t'u heqin kredencialet autoriteteve lokale.

2. Harmonizimi me direktivat e BE

Sa i përket ligjeve dhe zotërimit të njohurive dhe përmes procesit të shqyrtimit si pjesë e negociatave të anëtarësimit me BE, vlerësimi është pozitiv. Ajo që mungon është zbatimi i projekteve dhe zbatimi i ligjeve.

Rekomandime

Sipas hulumtimit të CIVILit të Gjellbër, mund të konstatohet se Qeveria gjatë pesë/gjashtë viteve të fundit ka punuar në disa fusha prioritare të agjendës së gjellbër. Kriza energjetike si pasojë e luftës në Ukrainë kontribuoi në përshpejtimin e procesit të përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, por për të vazhduar me ritëm të përshpejtuar në fusha të tjera, CIVILi i Gjellbër rekomandon:

1. Forcimi të kapaciteteve institucionale

Janë të nevojshme analiza dhe vlerësime se në cilat fusha të Agjendës së Gjellbër shteti ka më pak ekspertizë dhe ekspertizë brenda institucioneve dhe të plotësohet me ekspertë apo persona që do të marrin arsimin dhe njohuritë e duhura për një fushë të caktuar. Nëse vlerësohet të përdoren bashkëpunime të jashtme si dhe burime të BE.

1. Bashkëpunimi ndërmjet ministrive përkatëse

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është bartëse e përgjegjësive lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Por, puna e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës varet edhe nga bashkëpunimi me ministrinë e tjera që kanë kompetenca në fushën e ekonomisë, transportit, drejtësisë, agjencive shtetërore dhe inspektorateve. Prandaj, ai bashkëpunim duhet të forcohet dhe procedurat në lidhje me burimet financiare, infrastrukturën, zgjidhjet ligjore dhe zbatimin e ligjit duhet të jenë në afate kohore që nuk do të sfidojnë dhe ngadalësojnë punën e Qeverisë dhe Ministrisë së Mjedisit.

1. Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve publike komunale

Një nga problemet kyçe, si pasojë e krizës ekonomike që ndodhi në periudhën pas COVID-19, por edhe ndikimi i agresionit rus në Ukrainë, i çoi shoqëritë publike në varfërim të burimeve financiare dhe njerëzore. Edhe pse janë nën juridiksionin e komunave, megjithatë, në shumicën e rasteve shteti është i madh dhe është diçka që po analizohet për tejkalimin e problemit. Shërbimet komunale që paguajnë qytetarët janë me të njëjtin çmim, energjia dhe kostot e tjera janë rritur. Rekomandimi i CIVILit të Gjellbër është që shteti përmes pakove të masave kundër krizës t'i ndihmojë në shlyerjen e borxheve dhe fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve për mirëmbajtje në kohë dhe cilësore të hapësirës publike.

1. Bashkëpunim institucional në nivel lokal dhe qendror

Një nga problemet për realizimin e projekteve kapitale në kuadër të Agjendës së Gjellbër janë kompetencat më të mëdha që kanë komunat përmes decentralizimit. CIVILI i Gjellbër rekomandon që për të mos marrë kompetencat e shtetit, të kërkojnë ndihmë me iniciativën e tyre dhe të bashkëpunojnë me institucionet në nivel qendror që të mos pengohen proceset. Në atë bashkëpunim të ndërsjellë, të gjendet mënyra për të edukuar dhe punësuar inspektorë mjedisorë, mungesa e të cilëve është veçanërisht e dukshme në komunat më të vogla.

II. KONSENSUSI POLITIK

Si përgjigje në pyetjen nëse ka konsensus politik rreth çështjeve të gjelbra në vend, mund të nxirren dy përfundime:

- **Ka, kjo është e vetmja gjë për të cilën të gjithë bien dakord**

- **Ekziston, por në mënyrë deklarative, agjenda e gjelbër si prioritet kryesor varet nga situata aktuale politike**

Konteksti pozitiv dhe negativ i konstatimit se ka një konsensus politik buron nga ndarja ditore-politike në luftën e pushtetit për të thyer shpjegimet narrative të opozitës që vazhdimisht përpiqet të minojë angazhimet demokratike dhe evropiane të shtetit.

Rekomandime:

Në këtë drejtim, CIVILI i Gjellbër rekomandon që agjenda e gjelbër të jetë prioritet kryesor, i çliruar nga aspiratat politike për pushtet dhe supremaci të partive të caktuara politike. Me vendosjen e agjendës së gjelbër në krye të agjendave politike dhe partiake dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, arrihen rekomandimet e mëposhtme:

1. **Zhvillimi i qëndrueshëm është i mundur nëse krijohet një ekuilibër ndërmjet aspekteve ekonomike, sociale dhe mjedisore**

Nëse si synim parësor vendoset e ardhmja e gjelbër e vendit, atëherë konsensusi politik do të kontribuojë në zhvillim që do të përmirësojë standardet ekonomike, sociale dhe arsimore të qytetarëve.

2. **Fokusi duhet të jetë gjithmonë te qytetarët**

Nëse fokusi është tek qytetarët dhe ata janë interesi parësor i partive politike, atëherë nuk ka vend për negociata apo lojë me të ardhmen e tyre.

3. **Krijimi i kushteve më të mira jetësore**

Me angazhim të përbashkët në të gjitha fushat e agjendës së gjelbër për të kontribuar në shëndetin dhe standardin e jetesës së të gjithëve.

II. KEQPËRDORIME TË ÇËSHTJEVE TË GJELBRA

Shembujt më të zakonshëm të keqpërdorimit të çështjeve të gjelbra janë korrupsioni, premtimet në kuadër të zgjedhjeve, shpërdorimi i pushtetit, bllokimi i ligjeve në Kuvend, varësia nga partia, ndryshimi i strategjive dhe ligjeve në varësi të asaj partie në pushtet, loja me besimin e qytetarëve.

Rekomandime

Rekomandimet e CIVIL të Gjelbër rrjedhin nga përvoja shumëvjeçare në monitorimin e proceseve politike në vend dhe angazhimet e organizatës në luftën për të drejtat dhe liritë e njeriut, kundër korrupsionit, dezinformatave dhe lajmeve të rreme, në monitorimin e proceseve zgjedhore, si dhe në proceset integruese.

1. Premtime të ndershme dhe realiste për qytetarët

Në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme presidenciale dhe parlamentare në vitin 2024, CIVILi i Gjelbër rekomandon që programet zgjedhore të përfshijnë aktivitete nga çështjet e gjelbra që janë realisht të realizueshme dhe për të cilat ekziston mundësia e realizimit të tyre në mandatin që do t'u caktohet. Singëriteti në fjalimet e tyre publike do të kontribuojë gjithashtu në rritjen e besimit të qytetarët.

1. Përcaktimi i prioriteteve financiarisht të qëndrueshme dhe me kapacitete të mjaftueshme në burime njerëzore

Përcaktimi i buxhetit real dhe vlerësimi i fondeve që do të vinin përmes investimeve të huaja dhe fondeve evropiane, pa bërë premtime jo realiste dhe të arritshme dhe duke abuzuar kështu me agjendat e gjelbra për pikë politike.

2. Tejkalmi i keqpërdorimit të terminologjisë lidhur me agjendën e gjelbër për qëllime politike ditore

III. PERSPEKTIVAT MBI ÇËSHTJET KRYESORE TË GJELBRA NË VEND NË 10 VITET E ARDHSHME

Menaxhimi i mbetjeve dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë janë fusha kyçe ku mund të arrihet përparim i mundshëm, por janë gjithashtu në listën e prioriteteve. Ndotja e ajrit dhe mbrojtja e mjedisit nuk janë më pak të rëndësishme. Megjithatë, sipas konkluzioneve të CIVILit të Gjelbër, investimi më i madh duhet të bëhet në sistemin arsimor dhe edukimin e brezave të rinj, nga i cili varet tranzicioni i gjelbër dhe e ardhmja e gjelbër e vendit.

Konkluzioni i përgjithshëm është se jemi mbrapa me shumë procese, pikërisht për shkak të mungesës së vullnetit politik, interesimit apo mirëkuptimit të disa problemeve që lidhen me çështjet e gjelbra. Për këto arsye, integrimi në BE do të përshpejtojë proceset, por do të kontribuojë edhe në zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin në atë drejtim dhe sigurinë e shtetit. Në këtë kontekst, integrimi evropian dhe agjenda e gjelbër renditen si prioritet për Maqedoninë e Veriut.



Prioritetet

Me këtë projekt, CIVILI i Gjellbër përcakton edhe prioritetet në të cilat palët e ndryshme të interesit dhe subjektet vendimmarrëse duhet të forcojnë kapacitetet e tyre, dhe t'i përfaqëzojnë planet e tyre me mundësitë reale, por edhe me standardet e BE.

- **Transformimi i energjisë drejt burimeve të rinovueshme,**
- **Efikasiteti energjetik**
- **Rregullimi i mbetjeve**
- **Bujqësia**
- **Strategjia për veprimin klimatik,**
- **Ndotja e ajrit, tokës dhe ujit,**
- **Infrastruktura hekurudhore/transporti publik**
- **Aplikimi i ekonomisë qarkulluese**

Projekti "Forumi i Gjellbër" u zbatua në periudhën shtator-nëntor 2023, me mbështetjen e Fondacionit Heinrich Bell.

CIVIL, si një organizatë që përfshin CIVILin e Gjellbër, dhe gjithashtu si anëtare e nismave rajonale, duke përfshirë rrjetin e ekonomisë qarkore LogEx, vazhdon me angazhimet dhe kontributin e saj aktiv për çështjet e gjelbra në vend, rajon dhe botë.

Përgatiti: Biljana Jordanovska në bashkëpunim me ekipin e CIVIL

Përktheu: Dijana Tahiri